



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4484 .Prot.

Rrogozhinë, më 16.10.2025

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

Titulli : Konsultim me publikun për draft dokumentin e “ Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore 2026” dhe “Projekt Buxhetin Afatmesëm 2026-2028” të Bashkisë Rrogozhinë.

Propozues të projektakteve : Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS).

Qëllimi : Ky bashkëbisedim me banorët e komunitetit ka për qëllim mbledhjen e rekomandimeve, sugjerimeve, mendimeve në lidhje sistemin të Taksave dhe Tarifave Vendore 2026 dhe Projekt Buxhetin Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Rrogozhinë. Për të kuptuar problematikat e qytetarëve dhe prioritet për investime apo ndërhyrje të ndryshme nga ana e Bashkisë për rregullimin e cilësisë së jetës duke bërë nëse është e mundur ndryshime direkte në këto dy draft dokumente.

Gjithashtu rekomandimet janë të mirëpritura të dërgohen në adresën e emailit:
visi.shera85@gmail.com

Janë të ftuar të marrin pjesë :

Nga Bashkia : Kryetari i Bashkisë, Kryetarja, Anëtarët dhe Sekretari i Këshillit Bashkiak, Administratorët e Njësive Administrative Kryevideh, Lekaj, Gosë, Sinaballaj, Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), Koordinatorja për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Nga Komuniteti : Banorët e Bashkisë Rrogozhinë, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarët e biznesit, gazetarë, media etj.

Konsultimi zhvillohet në Qendrën Kulturore “Haxhi Memolla” Rrogozhinë ditën e Enjte datë 06.11.2025 ora 11:30^{oo}.

Forma e konsultimit: Takim në terren

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email: brrogozhine@gmail.com



Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik në terren synon mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me ndryshimet apo propozimet për ndryshime të projekt buxhetit të vitit 2026 -2028 dhe sugjerimeve për paketën fiskale 2026 në Bashkinë Rrogozhinë.
Përshkrimi i çështjes.	Miratimi i projekt buxhetit është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Po ashtu, paketa fiskale parashikon vendosjen dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe bën një parashikim të buxhetit dhe mbulimit të tij nga mbledhja e këtyre të fundit.
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresat e emailit të sekretarisë së Këshillit Bashkiak dhe Koordinatorit për Konsultimin me Publikun, BRENDA DATËS 7 Nëntor 2025. visi.shera85@gmail.com
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit : Si alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.
Projekt-vendimi, relacioni shoqërues, në lidhje me çështjen që konsultohet.	Materialet për konsultimin me publikun mund t'i gjeni në faqen web të bashkisë, faqja kryesore. https://bashkiarrogzhine.gov.al/konsultime-publike/



Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit	Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon: 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje; 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, (mbledhja e komisionit është e hapur për publikun) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Informimi i komunitetit, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre; 7. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 8. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 9. Monitorimi i zbatimit të tij.
Data e publikimit	16.10.2025

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETARE E KËSHILLIT

MUKADES GIXHARI

KRYETARI I BASHKISË

EDISON MEMOLLA

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email: brrrogozhine@gmail.com